

# PROTOKOLL

## I MENAXHIMIT TË RASTEVE TË DHUNËS NË FAMILJE NË NIVEL VENDOR, PËRMES MEKANIZMIT TË KOORDINUAR TË REFERIMIT (MKR) GJATË SITUATËS SË COVID-19



**Ending  
Violence  
Against  
Women**



# PROTOKOLL

## I MENAXHIMIT TË RASTEVE TË DHUNËS NË FAMILJE NË NIVEL VENDOR, PËRMES MEKANIZMIT TË KOORDINUAR TË REFERIMIT (MKR) GJATË SITUATËS SË COVID-19

BASHKIA .....

Miratuar nga Komiteti Drejtues  
i Mekanizmit të Koordinuar të Referimit,

Me Nr. Prot. \_\_\_\_\_ në mbledhjen e datës .....



Protokolli është përgatitur në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me mbështetjen e UNDP Shqipëri, në kuadër të Programit të Përbashkët të Kombeve të Bashkuara "Ti japim fund dhunës ndaj grave në Shqipëri" financuar nga Qeveria e Suedisë.





## TABELA E PËRMBAJTJES

HYRJE .....	7
1. RREGULLAT E PËRGJITHSHME PËR T'U MBROJTUR NGA RREZIKU I INFEKTIMIT/PËRHAPJES SË COVID-19 .....	8
2. MENAXHIMI I NJË RASTI EMERGJENT .....	10
3. MENAXHIMI I NJË RASTI JO EMERGJENT.....	17
4. MATERIALE TË TJERA INFORMUESE .....	20



# HYRJJE

Qëllimi i këtij protokoll është t'u vijë në ndihmë institucioneve përgjegjëse në nivel vendor, anëtarë të Mekanizmit të Koordinuar të Referimit (MKR) të rasteve të dhunës në familje, në mënyrë të veçantë anëtarëve të Ekipit Teknik Ndërdisciplinar (ETN), në menaxhimin e rasteve të dhunës në familje gjatë periudhës së fatkeqësisë natyrore për shkak të pandemisë së shkaktuar nga COVID-19.

Në 11 mars 2020, COVID-19 u deklarua nga Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH) si pandemi globale, ndërsa në 24 mars 2020, Qeveria e Shqipërisë shpalli gjendjen e fatkeqësisë natyrore, me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 243/2020 "Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore". Kjo situatë ka sjellë edhe nevojën për përshtatjen e një protokollit të veçantë me disa udhëzimeve të thjeshta dhe praktike për anëtarët e MKR, **për t'i konsideruar dhe respektuar gjatë menaxhimit të rasteve të dhunës në familje, përgjatë gjithë periudhës së pandemisë COVID-19.**

Ky Protokoll duhet të zbatohet duke marrë në konsideratë legjislacionin ekzistues, si dhe të gjitha VKM-të, Aktet Normative apo Udhëzimet dhe Urdhërat e nxjerra nga Qeveria e Shqipërisë për të përballuar situatën e pandemisë COVID-19. Pra këto hapa dhe udhëzime janë të vlefshme dhe të aplikueshme vetëm në kushtet e emergjencës së COVID-19 dhe zbatohen duke marrë në konsideratë të gjithë legjislacionin kundër dhunës në familje dhe Protokollin e Menaxhimit të Rasteve të dhunës në familje në nivel vendor përmes Mekanizmit të Koordinuar të Referimit (i miratuar nga Komiteti Drejtues i Mekanizmit të Koordinuar të Referimit në bashkinë tuaj), zbatimi i të cilave është detyrim në situatë normale.

Ky Protokoll përshkohet nga sjellja në vëmendje se autoritetet përgjegjëse duhet të përmbushin detyrimet ligjore në adresimin e dhunës në familje, me përparësi e përkushtim, edhe gjatë situatës së COVID-19.

# 1. RREGULLAT E PËRGJITHSHME PËR T'U MBROJTUR NGA RREZIKU I INFEKTIMIT/PËRHAPJES SË COVID-19

Në situatën e COVID-19, Qeveria e Shqipërisë ka ndërmarrë një sërë masash kufizuese për të parandaluar përhapjen e virusit në masë në komunitet. Distancimi social dhe izolimi janë prioritet, por pavarësisht disa kufizimeve në oraret e punës së punonjësve dhe punonjëseve të bashkive gjatë pandemisë, mbështetja dhe menaxhimi i rasteve të dhunës në familje edhe gjatë situatës së COVID -19, e cila mund të rrisë përhapjen e saj është e rëndësishme të mbetet prioritet. Kjo situatë kërkon marrjen e disa masave dhe ndjekjen e udhëzimeve me qëllim mbrojtjen e shëndetit të viktimës së dhunës në familje dhe/ose fëmijëve nga njëra anë, si dhe anëtarëve/profesionistëve të ETN-së nga ana tjetër të cilët menaxhojnë rastin.

Në këtë kuadër disa rregulla të përgjithshme duhet të jenë në qendër të vëmendjes së anëtarëve të MKR-ve, në mënyrë të veçantë të ETN-ve gjatë COVID-19, si më poshtë:

1. Ndiqni rregullisht njoftimet që jepen nga Instituti i Shëndetit Publik mbi përhapjen e pandemisë në nivel lokal, kombëtar, rajonal e botëror;
2. Përdorni maska, doreza, higjenzues, pastrues duarsh dhe desinfektuesit e nevojshëm për higjienën personale dhe të mjedisit ku punoni;
3. Informohuni vazhdimisht mbi masat parandaluese të përhapjes apo infektimit me COVID-19 dhe mënyrën e zbatimit të tyre në praktikë, si dhe përcillenit këtë informacion rregullisht edhe tek viktimat e dhunës në familje, sa herë që viheni në kontakt me to;
4. Afishoni në mjediset e punës suaj, veçanërisht aty ku zhvillonit veprime të caktuara për menaxhimin e një rasti të dhunës në familje, informacione mbi rregullat që duhet të ndiqen gjatë periudhës së emergjencës për shkak të pandemisë COVID-19;
5. Monitoroni dhe përmirësoni në mënyrë të vazhdueshme mbajtjen e higjienës së përditshme të mjediseve ku ju punoni apo ku organizoni takime të disa anëtarëve në funksion të menaxhimit të rasteve emergjente, për të shmangur rrezikun e përhapjes së mundshme të COVID-19;
6. Kujdesuni që të pastroni dhe higjienizoni vazhdimisht sende të përdorimit personal në zyrën tuaj si telefon, kompjuter, dyer, tavolina, dollapet e dosjeve, etj;
7. Sigurohuni që të keni gjithmonë gjendje mjete për mbrojtjen nga infektimi (maskë, doreza dhe pastrues duarsh), me qëllim që të mos gjendeni të papërgatitur (pra të keni mjete rezervë me vehte, për t'i përdorur për ju, viktimën dhe/ose dhunuesin në rast nevojë), në momentin që angazhoheni për të trajtuar një rast të dhunës në familje.
8. Sigurohuni që gjatë punës për menaxhimin e rasteve të dhunës në familje, të shmangni sa më shumë kontaktin me duar (ose nëse nevojitet të kryeni veprime kundër dhunuesit, të mbani doreza e më pas të merrni masa për të larë dhe higjienizuar duart menjëherë), të ruani distancën prej të paktën 1 metër gjatë



plotësimin të dokumentacionit përkatës, ose të mbani në mënyrë të detyruar maskën, si dhe t'i shpjegoni paraprakisht por edhe gjatë çdo hapi viktimës që këto masa janë të domosdoshme për të mbrojtur jetën e saj dhe tuajën.

9. Nëse gjatë punës suaj për menaxhimin e rastit ju nevojiten dokumente të cilat duhet të nënshkruhen edhe nga palët, në pamundësi të kushteve për larjen e duarve me ujë të rrjedhshëm dhe sapun, mbani me vete higjienizues duarsh me alkool dhe kërkoni personave që do të nënshkruajnë dokumentet të higjienizojnë duart paraprakisht. Bëni kujdes, të shmangni në maksimum prekjen me duar të fyturës, gojës, hundës, etj.
10. Mbani dritaret hapur dhe ajroseni sa më shumë vendin e punës, sidomos dollapët ku mbani dokumente që qarkullojnë vazhdimisht dhe preken nga njerëz të ndryshëm. Sigurohuni të lani duart me ujë të rrjedhshëm dhe sapun dhe t'i desinfektoni ato menjëherë pas mbarimit të veprimeve me dokumentacionin e rastit.
11. KVDHF duhet të marrë masa të evidentojë të gjitha adresat dhe numrat e telefonit të ofruesve të shërbimeve (psikologjike, ligjore, strehim, etj), duke i hedhur ato në një listë, me qëllim që t'ua vërë në dispozicion edhe punonjësve të policisë apo antarëve të tjerë të ETN. Kjo listë është mirë t'u përcillet të gjithë antarëve të ETN me e-mail për ta mbajtur në konsideratë. Një kopje të saj KVDHF duhet ta ketë gjithmonë me vete kur shkon për të marrë kontakt me një viktimë (apo ta mbajë pranë nëse kontakton me viktimën përmes telefonit);
12. Nëse KVDHF ka shenja paralajmëruese të një infektimi të mundshëm nuk del nga shtëpia dhe qëndron në kushte të vetë-izolimit, duke marrë këshilla edhe nga shërbimi shëndetësor përmes mjekut të familjes. Nëse shenjat kthehen në simptomat e para, atëhere njofton menjëherë urgjencën në numrin 127. Nëse shenjat zhduken, pra KVDHF ka kaluar vetëm një situatë gripale, këshillohet qëndrimi i tij/i saj në shtëpi edhe për të paktën 2-3 ditë të tjera, pas kalimit të gripit. Vendimi për t'u kthyer në punë merret vetëm me miratimin e mjekut të familjes. Ndërkohë, që ditën e parë të qëndrimit në shtëpi njofton Përgjegjësin e Sektorit/Drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Sociale në Bashki, i cili duhet të marrë menjëherë masat me qëllim caktimin e një punonjësi tjetër të bashkisë me detyrën e KVDHF për menaxhimin e rasteve të dhunës në familje. Kontaktet e këtij personi i vihen menjëherë në dispozicion policisë dhe edhe vetë KVDHF, i/e cili/a nëse merr telefonatë për ndjekjen e një rasti të caktuar nga një antar i ETN-së duhet të dijë se ku ta referojë menjëherë rastin brenda bashkisë. KVDHF nëpërmjet telefonit, që në ditën e parë të qëndrimit në shtëpi, duhet të komunikojë me kolegun/en që i caktohet përkohësisht mbulimi i funksionit të tij/saj, nëse ka në ndjekje ndonjë rast të caktuar dhe ka hapa që duhet të plotësohen në këtë drejtim, apo dhe ta orientojë se ku mund të gjendet dokumentacioni i nevojshëm për përdorim nëse do të evidentohet një rast konkret. Punonjëses që ngarkohet me përgjegjësinë e mbulimit të funksionit të KVDHF përkohësisht, i bëhet e qartë që në fillim rëndësia e pozicionit dhe detyrimi për ruajtjen e konfidencialitetit nëse do të asistojë në menaxhimin e një rasti dhune në familje. Po kështu, njoftohen të gjithë kolegët me të cilat/cilët KVDHF ka qenë në kontakte gjatë punës, që të monitorojnë me kujdes situatën e tyre shëndetësore, pa panik. Kjo vlen edhe për Punonjësën për Mbrojtjen e Fëmijëve i cili luan një rol të rëndësishëm në menaxhimin e rasteve të fëmijëve të mbijetuar nga dhuna e drejtëpërdrejtë apo e asistuar.

## 2. MENAXHIMI I NJË RASTI EMERGJENT

**Gjatë menaxhimit të një rasti emergjent duhet të mbahen parasysh udhëzimet si më poshtë:**

- Nëse policia është pika e parë e kontaktit, pavarësisht nëse njoftimi/denoncimi për rastin e dhunës në familje është marrë përmes telefonit, komunikimit me mjete elektronike, apo paraqitjes së viktimës direkt në mjediset e policisë, punonjësi i policisë, KVDHF dhe anëtarët e tjerë të ETN-së, të cilët do të kryejnë vlerësimin e riskut dhe do të përmbushin nevojat urgjente të rastit, duhet të ndjekin protokolle të rrepta për t'u mbrojtur nga infektimi dhe përhapja e COVID-19 si distancimi shoqëror, përdorimi i mjeteve mbrojtëse dhe marrja e masave higjieno-sanitare. Nëse viktimja ka dalë nga shtëpia dhe është paraqitur në mjediset e policisë pa leje të miratuar apo jashtë orarit të lejuar për qarkullim, të merren masa që të shmangët ndëshkimi i saj, për shkak të situatës që e ka detyruar të shkelë rregullat e vendosura për respektim gjatë emergjencës për shkak të pandemisë COVID-19. Kryetarët/et e bashkive si drejtues/e të MKR-ve pajisin KVDHF dhe NJMF/PMF me autorizim lëvizjeje për nevoja të menaxhimit të rasteve të dhunës në familje gjatë situatës së COVID-19. Këto autorizime për lëvizje vleftësohen vazhdimisht në varësi të ndryshimit të udhëzimeve për lëvizje nga Qeveria dhe merren masa që të përditësohen sipas nevojës. Policia lehtëson procesin e denoncimit të rasteve të dhunës në familje. Punonjësit e policisë së shtetit marrin në konsideratë dhe trajtojnë me përparësi çdo njoftim që marrin, në çfarëdo forme dhe nga cilido person që sinjalizon për një situatë dhune ose situatë të mundshme dhune.
- Punonjësi i Policisë së Shtetit i ngarkuar për kryerjen e vlerësimit e riskut njofton KVDHF pranë njësisë përkatëse të vetëqeverisjes vendore, i/e cili/a mund të asistojë në hartimin e raportit të vlerësimit të riskut për rastin e dhunës në familje. Kur KVDHF nuk mund të paraqitet personalisht, zëvendësohet menjëherë nga një punonjës/e social/e i strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore në njësitë e vetëqeverisjes vendore. Mosparaqitja në kohë e KVDHF/punonjësit social të strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore në njësinë e vetëqeverisjes vendore, nuk përbën shkak për ndërprerjen e vlerësimit të riskut ose për vonesa në hartimin e raportit nga policia.
- Kur nga vlerësimi i riskut i kryer nga policia dhe/ose asistuar nga KVDHF rezulton se viktimja madhore është në risk "të lartë" ose "të mesëm" për jetën, merren masa të menjëhershme për sigurinë e viktimës/ave dhe veçimin e viktimës nga dhunuesi, duke konsideruar se qëndrimi i detyruar në një shtëpi gjatë COVID-19 është faktor favorizues për përsëritjen e dhunës, përshkallëzimin e saj dhe rritjen e rrezikut për jetën. Largimi i dhunuesit nga banesa, duhet të jetë përparësi kur nga vlerësimi i riskut rezulton se viktimja është në rrezik për jetën. Policia duhet të përfshijë këtë masë në UMPMM si dhe të veprojë menjëherë për largimin e dhunuesit/es nga banesa.
- Kur strukturat e policisë paraqiten në vendngjarje dhe fillojnë procedurat për trajtimin e rastit të dhunës së denoncuar, njoftojnë përveç Koordinatorit/ es Vendor/e kundër Dhunës në Familje të bashkisë në territorin e së cilës ka

ndodhur ngjarja (në zbatim të pikës II.5 të Udhëzimit të Përbashkët të Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, nr. 866, datë 20.12.2018 "Për procedurat dhe modelin e vlerësimit të riskut për rastet e dhunës në familje"), edhe Punonjësen e Njesisë së Mbrojtjes së Fëmijëve (në zbatim të pikës II.6 të së njëjtit Udhëzim), edhe kur nuk është denoncuar dhunë e ushtruar tek fëmijët. Pavarësisht se denoncimi mund të jetë bërë për dhunë të ushtruar ndaj një personi të rritur, mundësia që fëmijët të kenë asistuar në skena dhune është e lartë për shkak të qëndrimit të tyre në shtëpi gjatë COVID-19. Si në rastet kur fëmijët janë dhunuar drejtëpërdrejt ashtu edhe kur kanë asistuar në skena dhune, nevoja e tyre për siguri është emergjente. Në vendimin e Urdhërit për Masa Paraprake të Mbrojtjes së Menjëhershme, të lëshuar për viktimat të cilat rezultojnë në rrezik të lartë për jetën, përfshihen domosdoshmërit edhe fëmijët e tyre, edhe kur nuk janë përballur me dhunë të drejtëpërdrejtë por të asistuar. Nevojat e fëmijëve për trajtim psikologjik në këto raste duhen përmbushur nga "ekipi bërthamë" i ETN. Gjatë trajtimit të rasteve të tilla, PMF/NJMF komunikon edhe me Drejtorinë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror (që është edhe antar i MKR/ETN-së) për një menaxhim sa më efektiv të rastit të viktimës së mitur, përmes ofrimit të shërbimeve sa më pranë viktimës dhe në përputhje me nevojat emergjente dhe afatgjata të identifikuara.

- Nëse vendi ku është identifikuar ose raportuar rasti i dhunës në familje është i ndryshëm nga ai i vendbanimit të viktimës ose dhunuesit, punonjësi i policisë i ngarkuar të kryejë vlerësimin e riskut mund të kërkojë informacion me telefon ose me mjete komunikimi on line nga struktura përgjegjëse e Policisë së Shtetit të vendbanimit të tyre.
- Kur policia referon rastin pranë Njesisë për Mbrojtjen e Fëmijëve në njësinë e vetëqeverisjes vendore dhe Punonjësit(es) për Mbrojtjen e Fëmijëve në njësitë administrative të Bashkisë, respekton rregullat e parashikuara në legjislacionin në fuqi për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës dhe referohet në Udhëzimin Nr. 253, datë 10/04/2020, të Ministres së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale "Për menaxhimin e rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje gjatë periudhës së fatkeqësisë natyrore për arsye të pandemisë së shkaktuar nga COVID-19". Struktura përgjegjëse pranë Policisë së Shtetit harton raportin e vlerësimit të riskut në prani të përfaqësuesit/es të NJMF-së në Bashki / Punonjësit/es për Mbrojtjen e Fëmijëve (PMF) në njësitë administrative të Bashkisë duke respektuar distancimin shoqëror dhe përdorimin e mjeteve mbrojtëse si dhe masave të higjienës.
- Koordinator/i Vendor/e kundër Dhunës në Familje, dhe në rastin e fëmijëve Punonjësi/ja për Mbrojtjen e Fëmijëve si dhe cilido anëtar i Ekipit Teknik Ndërdisciplinor që do të kontaktojë me rastin në polici apo në banesë, duhet të pajisen menjëherë me leje qarkullimi nga policia për të lëvizur në çdo orar si dhe duhet t'u sigurohet logjistika e nevojshme për të realizuar vizitën në shtëpi apo në mjediset e policisë.  
Këshillohet që informacionet nga institucionet, organizatat ose individë që kanë dajeni për rastin të merren me telefon apo mënyra të tjera të komunikimit online (e-mail, skype, zoom, etj) dhe jo me kontakt ballë për ballë.
- Përfaqësuesi i Policisë së Shtetit dhe/ose KVDHF, nëse thirren nga gjykata në procesin e vlerësimit të UMPMM marrin masa të përdorin mjete mbrojtëse dhe ruajnë distancën kur paraqiten në seancë gjyqësore; Punonjësi i Policisë që ka

- kryer vlerësimin e riskut dhe përgatitur dosjen e UMPMM-së dhe KVDHF që e ka asistuar duhet të jenë në dispozicion dhe të gatshëm të marrin pjesë në seancën e gjykimit të vlerësimit të UMPMM-së edhe nëpërmjet mjeteve të komunikimit (elektronike), për të dhënë shpjegime mbi provat e paraqitura.
- Nëse punonjësi i policisë dhe/ose KVDHF shoqërojnë viktimën e dhunës në familje në spital ose në një ofrues shërbimesh përdorin mjete mbrojtëse dhe ruajnë distancimin fizik. Gjatë vlerësimit të riskut, punonjësi i policisë dhe KVDHF apo edhe PMF të pranishëm në proces, duhet të tregojnë kujdes maksimal për të identifikuar shërbimet e mundshme dhe më të përshtatshme në përmbushje të nevojave emergjente të rastit.
  - Kur paraqitet e domosdoshme për shkak të riskut përjetën e viktimës, kur punonjësi (ja) i/e policisë i sugjeron titullarit të strukturës së policisë vendosjen e viktimës në një qendër të specializuar rezidenciale, publike ose jo-publike (emergjente ose afatgjatë), veprohet duke mbajtur parasysh edhe sqarimet e paraqitura në vijim në seksionin përkatës të këtij Protokollit ("nevoja për strehim").
  - Nëse janë të nevojshme shërbime avokatie rasti kontaktohet nga avokati i kontraktuar nga bashkia (kur është rasti) apo referohet në listën e ofruesëve të shërbimeve ligjore falas nëpërmjet telefonit ose emailit, apo faqeve të facebook të ofruesve të shërbimeve ligjore falas. Referojuni për kontakte Aneksit Nr. 4 të "Protokollit i Menaxhimit të Rasteve të Dhunës në Familje në nivel vendor përmes MKR-së".
  - Ndhimë juridike parësore ofrohet online në platformën [juristionline.al](http://juristionline.al)
  - Gjithashtu shërbimet psikologjike për viktimën dhe/ose fëmijët, mund të ofrohen menjëherë nëpërmjet telefonit nga psikologjia e bashkisë (kur është rasti) apo duke e lidhur rastin me shërbimet e mëposhtme:
    - Linja Kombëtare e Këshillimit për Gra dhe Vajza në numrin falas 116-117;
    - Në platformën e Urdhrit të Psikologut, Psikologët Shqiptarë on line, numrat e telefonit të cilëve janë publikuar në faqen zyrtare të Urdhrit të psikologut (<https://www.urdhriipsikologut.al/covid-19-psikologet-shqiptare-online/>);
    - Psikologët e shkollave, bashkive apo OJF-ve nëpërmjet telefonit;
  - Viktima duhet të informohet në një gjuhë të qartë dhe të kuptueshme për përshtatjen e mbështetjes dhe të masave shtesë që merren për të parandaluar rrezikun nga infektimi apo përhapja e COVID-19 dhe faktin që prioriteti është jeta e viktimës dhe/ose fëmijëve të saj, si edhe anëtarëve të MKR/ETN që menaxhojnë rastin;
  - Nëse rezulton se alternativa që do të ndiqet është strehimi i viktimës tek familjarët apo të afërmit e saj, atëherë merren masat për të ndjekur hapat në vijim:
    - o Në prani të viktimës komunikohet me telefon me familjarët/të afërmit dhe merret konfirmimi që ata janë dakord të strehojnë viktimën (dhe fëmijët e saj) në shtëpinë e tyre deri në përfundim të rrezikut nga panedemia COVID-19.
    - o Sqarohen si viktima (dhe fëmijët e saj) edhe familjarët/të afërmit paraprakisht se viktima dhe fëmijët do të duhet të qëndrojnë në kushte të vetëizolimit në një dhomë për 14 ditë, për të shmangur rrezikun e një infektimi të mundshëm (detajet për vetëizolimin është mirë t'i jepen me vehte viktimës edhe të shkruara - sipas formateve që ka apo mund të përgatisë qendra shëndetësore).

- o Nëse pranohen nga të dy palët këto kushte, do të theksohet gjithashtu që shërbimet e tjera si psikologjike, ligjore etj., do të jepen nëpërmjet telefonit dhe në rast nevojë do të kontaktohet viktimja nga antarët e ETN, në banesën ku do stehohet gjatë kësaj periudhe.
  - o Nëse banesa ku do të strehohet gjatë kësaj periudhe është në një qytet tjetër, paraprakisht do të merren të gjitha masat të konfirmohet gadishmëria e ETN-së në atë qytet/bashki për të ofruar shërbimet e duhura për viktimën (dhe fëmijët e saj) në rast nevojë. Shërbimet telefonike mund të vijojnë të jepen nga antarët e ETN-së ku ka ndodhur rasti si dhe nga organizatat apo profesionistët ndihmës, siç janë cituar më tej në këtë dokument.
  - o Përpara se të mbështetet viktimja për t'u strehuar në banesën tjetër (pra të shoqërohet, transportohet për atje), nuk duhet të harrohet të merret informacion nëse ndonjë nga të afërmit ka pasur temperaturë apo kollë dy ditët e fundit dhe e njëjta gjë do duhet të duhet edhe për viktimën dhe fëmijët. Nëse nuk ekziston asnjë nga këto shenja, duhet të bëhet shoqërimi i viktimës në shtëpinë e të afërmeve. Nëse ka shenja njëra palë, duhet të merret vendimi vetëm pas konsulimit me shërbimin shëndetësor që është edhe antar i ETN/KD të MKR përkatëse.
  - o Kur është rasti që viktimja strehohet tek të afërmit ose familjarët e saj, rasti monitorohet rregullisht nëpërmjet telefonit dhe kur është e mundur vizitave në banesë nga policia dhe KVDHF për arësye se konflikti mund të spostohet apo përshkallëzohet duke vënë në rrezik sigurinë e viktimës dhe familjarëve apo të afërmeve të saj.
- **KUJDES!** Zbatimi i masave të përshkruara më sipër dhe të gjithë masave të tjera parandaluese e mbrojtëse për të shmangur rrezikun e infektimit me COVID-19, të përshkruara në të gjitha vendimet apo aktet e tjera ligjore të nxjerra nga Qeveria e Shqipërisë, në asnjë mënyrë nuk duhet të përbëjnë shkak për mos dhënie të shërbimit, apo për diskriminimin për shkak të situatës shëndetësore, si dhe duhet të aplikohen në atë mënyrë që të shmangin bullizmin apo neglizhimin, si me palët në një rast që menaxhohet, ashtu edhe ndërmjet kolegëve.
  - Policia ndan informacion se punonjësit e policisë janë të gatshëm për t'u përgjigjur menjëherë dhe për t'i ndjekur rastet e dhunës në familje, përmes të gjitha mjeteve të komunikimit social që ka policia (përfshirë dhe faqet e Facebook, Policit Virtual, etj.).
  - MKR ndan informacion mbi gadishmërinë e të gjitha institucioneve anëtare të MKR në trajtimin e rasteve të dhunës në familje përmes mediave sociale të bashkisë përkatëse dhe materialeve informuese të publikuara on line nga KVDHF të cilat përfshijnë numra kontakti dhe përgjigjen e MKR gjatë COVID-19.

## Gjatë zbatimit të urdhërave të mbrojtjes:

- Një kopje e urdhërit për masat paraprake të mbrojtjes së menjëhershme i njoftohet menjëherë KVDHF duke përdorur mjete të komunikimit on line si email.
- Policia ka detyrë të informojë dhunuesin ndaj të cilit është dhënë urdhëri, në lidhje me masat që parashikon UMPMM-ja dhe detyrimin e tij për ti zbatuar ato vullnetarisht. Policia ka detyrë të informojë viktimën e dhunës në familje në lidhje me masat që parashikon UMPMM-ja. Për informimin e tij/saj mund të përdoret edhe komunikimi me telefon apo alternativa të tjera komunikimi on line.
- Policia lehtëson punën e zyrave të shërbimeve sociale në njësitë e vetëqeverisjes vendore, në lidhje me monitorimin e respektimit të urdhërave të mbrojtjes nga palët. Specialistët e Policimit në Zonë mbështesin KVDHF për të kryer monitorimin e rregullt të respektimit të UM nga palët, duke përfshirë edhe shoqërimin në vizita në banesë për kryerjen e këtij vlerësimi. Për këtë qëllim, do të paraqitet pranë Komisarariatit përkatës një kërkesë me shkrim nga Bashkia ku të jepen të dhënat e personit që do të kryejë monitorimin si dhe një listë e familjeve ku do të kryhet monitorimi (pra lista e viktimave me UM) dhe adresave përkatëse. SPZ-të mund të koordinohen me Koordinator/et Vendor/e për ditët dhe oraret e lëvizjeve për të kryer monitorimet përkatëse.
- KVDHF dhe zyra e shërbimeve sociale në bashki, e cila monitoron respektimin e urdhrit të mbrojtjes nga palët, në bashkitë/njësitë administrative kur nuk ka asnjë tregues për persona të infektuar me COVID-19, respektojnë distancimin shoqëror dhe përdorimin e mjeteve mbrojtëse si dhe masave të higjenes (të përshkruara në këtë dokument, por edhe në të gjithë dokumentat e tjerë të publikuar për këtë qëllim nga ISHP, MSHMS dhe OBSH) gjatë procesit të monitorimit dhe vizitës në shtëpi.
- Kur ka të dhëna për praninë e virusit COVID-19, monitorimi i rastit kryhet fillimisht nëpërmjet telefonit duke u siguruar që viktimat dhe/ose fëmijët e saj janë mirë me shëndet. Nëse nuk arrihet kontaktimi nëpërmjet telefonit, apo nëse nga komunikimi vihen re shenja të hezitimit për të folur, të cilat mund të paralajmërojnë për një situatë ku viktimat mund të jetë nën presion, atëherë merren masa në koordinim me policinë, për të shkuar menjëherë në banesë dhe për të kryer monitorimin atje.
- Kur nga monitorimi rezultojnë shkelje të UMM/UM-së të raportuara nga viktimat, Koordinator/ja Vendor/e kundër Dhunës në Familje, apo të evidentuar nga vetë SPZ-të, rasti të ndiqet menjëherë sipas parashikimeve ligjore, me përparësi dhe përgjegjësi maksimale duke u vënë në lëvizje edhe anëtarë të tjerë të MKR si prokuroria, gjykata, etj. Në të gjitha hapat që ndërmerren, mbahen në konsideratë rregullat e përshkruara më sipër në këtë Protokoll, për t'u mbrojtur nga rreziku i infektimit me COVID-19, të cilat zbatohen me përpikmëri



**Kur nevojitet ofrimi i shërbimit të strehimit të rastit** në një nga strehëzat ekzistuese publike dhe jo- publike:

- UMPMM-ja mund të vendosë viktimën në një qendër rezidenciale ose emergjente për viktimat e dhunës në familje, vetëm në rastin e rrezikut për jetën, duke marrë parasysh vullnetin e saj, interesin më të lartë të fëmijës, si dhe duke respektuar legjislacionin në fuqi për standardet e këtyre qendrave.
- Punonjësi i policisë dhe KVDHF duhet të marrin masat e nevojshme për të referuar rastin në një qendër publike apo jo-publike që ofron shërbim strehimi emergjent ose afatgjatë, duke mbajtur parasysh faktin që në kushtet e emergjencës së pandemisë COVID-19, këto qendra punojnë në mënyrë më të kufizuar dhe me rregulla strikte të pranimit të rasteve të reja. Për këtë qëllim, rekomandohet që KVDHF të njohë mirë përmbajtjen e "Protokollit të funksionimit të qendrave rezidenciale publike dhe jo-publike që ofrojnë shërbimin e strehimit (strehëzat) për viktimat e dhunës në familje dhe trafikimit në situatën e pandemisë së COVID-19", miratuar me Urdhër të Ministres së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 254 datë 10.04.2020, me qëllim që të dijë se çfarë shpjegimesh do të duhet t'i jepen viktimës dhe/ose fëmijëve përpara vendosjes së tyre në qendër (shiko sidomos kapitullin 3 të Protokollit të sapocituar).
- Nëse në NJVV ku ndodh rasti apo në NJVV afër ekziston një strehëz emergjente (publike apo jo-publike) atëherë ETN duhet të çmojë në vendimin që merr, se sa e mundur është që viktima dhe/ose fëmijët e saj të strehohen në këtë qendër, duke pasur parasysh respektimin e standardeve minimale të ofrimit të shërbimit në këto strehëza, bazuar në Udhëzimin e Ministres së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 744 datë 15.11.2019 "Për miratimin e standardeve minimale të shërbimeve të përkujdesit shoqëror, për viktimat/të mbijetuarat e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje në qendrat rezidenciale emergjente (afatshkurtëra) publike dhe jo-publike (strehëzat emergjente)". Kjo nënkupton gjithashtu që institucioni që menaxhon shërbimin e strehimit emergjent në nivel vendor (pra bashkia ose një OJF e specializuar), të marrë në konsideratë ofrimin e këtij shërbimi duke përbushur nevojat bazë të rastit (ushqim, veshje, mjete higjieno-sanitare), si dhe të sigurojë përmes bashkëpunimit me ETN, me Urdhërin e Psikologut, apo me OJF të specializuara, ofrimin me telefon të shërbimit të këshillimit psikologjik (sidomos ku streheza menaxhohet nga Bashkia dhe stafi përgjegjës mund të mos ketë formimin e duhur në këtë drejtim), ligjor, mbështetjes emocionale për viktimën dhe fëmijët, etj.
- Nëse flitet për strehimin vetëm të fëmijëve të dhunuar (pra të pashoqëruar nga prindërit e tyre) atëherë do të procedohet sipas hapave të specifikuar në Udhëzimin nr. 253 datë 10.04.2020 "Për menaxhimin e rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje gjatë periudhës së fatkeqësisë natyrore për arësye të epidemisë së shkaktuar nga COVID-19".
- Nëse përbushen pikat më sipër dhe merret vendimi që viktima (dhe fëmijët e saj) të strehohen në strehëzën e emergjencës, atëherë institucioni që e menaxhon këtë shërbim, duhet të marrë masat që:

- o Mjedisi i strehëzës emergjente të jetë i pajisur me sasinë e duhur të sapunit, detergjentëve dhe desinfektuesve të nevojshëm për t'u përdorur përgjatë gjithë qëndrimit aty të viktimës (dhe fëmijëve të saj).
  - o Të jenë të afishuar në vende të dukshme rregullat e funksionimit të strehëzës gjatë situatës së emergjencës së COVID-19, si dhe rregullat specifike të larjes së duarve e mbajtjes së higjienës vetjake dhe të mjedisit në strehëz.
  - o Për të krijuar mundësinë e kalimit të kohës sa më qetë e aktivisht, strehëza të jetë e pajisur me lodra për fëmijë, si dhe me libra për fëmijë e të rritur.
  - o Në rast të nevojës për furnizim me ushqime apo mjete të tjera nga jashtë, të merren masa që të lihen tek dera e dhomës/strehëzës të paketuara mirë dhe të udhëzohet çpaketimi menjëhershëm i tyre dhe hedhja e qeseve në kosh dhe larja menjëherë e duarve (për më shumë detaje këtu referohuni edhe tek "Protokolli i funksionimit të qendrave rezidenciale publike dhe jo-publike që ofrojnë shërbimin e strehimit (strehëzat) për viktimat e dhunës në familje dhe trafikimit në situatën e pandemisë së COVID-19", miratuar me Urdhërin nr. 254/2020 të Ministres së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, kryesisht kapitullit 3 të tij).
  - o Të plotësojë nevojat e viktimës për shërbim psikologjik dhe këshillim ligjor (nëpërmjet telefonit, apo internetit) dhe kur nevojitet domosdoshmërisht ballë për ballë, të bëhet duke respektuar në mënyrë strikte rregullat e shmangies së rrezikut nga infektimi me COVID-19.
  - o Të sigurohet ofrim i shërbimit në përputhje me standardet minimale të funksionimit të strehëzave emergjente, siç parashikohet në Udhëzim nr. 744 datë 15.11.2019 "Për miratimin e standardeve minimale të shërbimeve të përkujdesit shoqëror, për viktimat/të mbijetuarat e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje në qendrat rezidenciale emergjente (afatshkurtëra) publike dhe jo-publike (strehëzat emergjente)"
- Para vendosjes së viktimës dhe/ose fëmijëve të saj në strehëz merret informacion i detajuar nga viktimja dhe familjarë të saj në lidhje me mundësinë që ajo dhe/ose fëmijët e saj të jenë të infektuar nga COVID-19; Gjatë qëndrimit të viktimës dhe ose fëmijëve në strehëzën emergjente monitorohet rregullisht temperatura (matja e saj të paktën dy herë në ditë, jo me termometër nga goja) dhe mbahen kontakte me mjekun e familjes për çdo nevojë ose konsultim në lidhje me shëndetin.
  - Në vijim të këtyre udhëzimeve të paraqitura në këtë Protokoll, për çdo detaj lidhur me mënyrën e funksionimit të strehëzës emergjente gjatë kësaj periudhe të emergjencës për shkak të COVID-19 referohuni edhe në Protokollin "Për qendrat rezidenciale publike dhe jo publike që ofrojnë shërbimin e strehimit (strehëzat) për viktimat e dhunës në familje në situatën e pandemisë së COVID-19".

Nëse viktimat e dhunës në familje rezultojnë të infektuara me COVID-19, në marrëveshje dhe bashkëpunim me ISHP, SHSSH dhe MSHMS, merren masa për ofrimin e mbështetjes së domosdoshme psikologjike dhe/ose ligjore në kushtet e hospitalizimit, për aq kohë sa janë në kushte shëndetësore stabilë (jo në terapi intensive të intubuar).



KUJDES! Në menaxhimin e një rasti emergjent edhe gjatë situatës së pandemisë së COVID-19, mund të lindë nevoja të përfshihen një numër i anëtarëve të ETN-së, si ata që përcaktohen të angazhohen si "ekipi bërthamë", edhe të tjerë, në varësi të nevojave të identifikuara. Prandaj gjatë trajtimit të rastit emergjent edhe për periudhën e pandemisë së COVID-19, do të mbahen në konsideratë të gjitha veprimet që mund të ndërmarrin anëtarët e ETN-së siç përshkruhen në seksionin 4.3.1. të "Protokollit të Menaxhimit të rasteve të dhunës në familje nëpërmjet Mekanizmit të Koordinuar të Referimit", duke i zbatuar ato përmes ndjekjes dhe aplikimit me përpikmëri të rregullave të përgjithshme të përshkruara në seksionin 1 të këtij Protokoll. Hapat e menaxhimit të rastit kërkohet sërish të ndiqen me përpikmëri dhe po kështu të përdoren edhe të gjithë formatet e paraqitura në anekset përkatëse të Protokollit të menaxhimit të rasteve në jo në kushte emergjence, në varësi të karakteristikave dhe nevojave të rastit për trajtim emergjent, POR gjithmonë duke bërë maksimumin e mundshëm për zbatimin e rregullave të përgjithshme kundër pandemisë së COVID-19

### 3. MENAXHIMI I NJË RASTI JO EMERGJENT

- Në kushtet kur mbledhjet fizike të ETN-së janë të ndaluara sipas vendimeve për situatën e COVID-19, këshillohen që mbledhjet e ETN-së sipas nevojave të rasteve të mbahen online duke përdorur platformat që janë më praktike për të gjithë antarët (Skype, Zoom, Google Meet, Messenger, etj). KVDHF koordinon realizimin e këtyre mbledhjeve. Sugjerohet mbajtja e një komunikimi të rregullt mujor me anëtarët e ETN-së edhe nëse gjatë një muaji nuk ka pasur raste për t'u menaxhuar, apo nëse rastet janë menaxhuar vetëm me dy tre prej antarëve të ETN-së. Në këtë kuadër KVDHF duhet të përgatisë dhe të qarkullojë me e-mail një informacion mujor tek të gjithë anëtarët, njëlloj siç duhet të veprojë për qarkullimin e procesverbalit të mbledhjeve mujore, edhe kur ato organizohen online.
- Në mbledhjet on-line të ETN, përfaqësuesi i Gjykatës ndan informacion me anëtarët mbi mënyrën e funksionimit të gjykatës gjatë COVID-19 dhe çfarë do të ndodhë me vijimësinë e çështjeve gjyqësore që kanë viktimat e dhunës në familje, si dhe afatet e ankimit gjatë kohëzgjatjes së gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga përhapja e COVID-19.
- Përfaqësuesi i Zyrës së Përmbarrimit ndan informacion mbi aktet normative për veprimtarinë e shërbimit përmbarrimor gjyqësor gjatë kohëzgjatjes së gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga COVID-19.
- KVDHF asiston viktimat nëpërmjet një materiali të përgatitur dhe printuar me informacion mbi të drejtat e tyre dhe ndjekjen e procedurave të nevojshme për marrjen e një urdhëri mbrojtjeje si dhe për hapat që duhen ndjekur nëse urdhëri shkelet, për rastet e mos pezullimit të seancave gjyqësore si për shqyrtimin e urdhrave të menjëhershëm të mbrojtjes dhe urdhrave mbrojtës si dhe kërkesave

të çështjeve familjare me karakter urgjent, kërkesave me objekt gjykimi kujdesin, detyrimet dhe respektimin e të drejtave të të miturve, kujdestarinë dhe birësimin, masat mbrojtëse ndaj dhunës në familje, ushtrimin e përgjegjësisë prindërore, përkujdesjen dhe detyrimet për ushqim, pezullimin e afateve të ankimit dhe padive, shmangjen e grumbullimeve në gjykatë, përdorimin e mjeteve mbrojtëse në gjykatë, zbatimin e vendimeve gjyqësore, etj. Ky informacion mund të ndahet me viktimën e dhunës në familje edhe me telefon.

- Për çdo rast të dhunës në familje në ndjekje, KVDHF përcjell informacion në Drejtorinë e Financës së bashkisë me qëllim që të përfshihet në listat e personave që kanë nevojë për mbështetje ekonomike, që i dërgohet Prefekturës për t'u paraqitur pranë Komisionit Qendror për Ofrimin e Asistencës dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile, në përputhje me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 236 datë 19.03.2020 "Për marrjen e masave për ofrimin e asistencës në banesë ndaj shtresave në nevojë, në kushtet e epidemisë së shkaktuar nga COVID-19".
- Të gjithë Anëtarët e ETN duhet të marrin pjesë në mbledhjet on-line të ETN dhe duhet të angazhohen për përmbushjen e nevojave të rastit.
- Zyra e Punës përgatit një informacion në gjuhë të thjeshtë në lidhje me procedurat, dokumentacionin dhe masën e ndihmës financiare për të punësuarit aktualë dhe punonjësit e larguar nga puna si pasojë e COVID-19 dhe e ndan në mbledhjen e ETN. Për rastet e trajtuara në mbledhjen on line të ETN diskutohet edhe mbi një plan post COVID-19 për mbështetjen e rasteve me kurse formimi profesional apo mundësi punësimi. KVDHF informon në vazhdimësi Zyrën e Punës për rastet e dhunës në familje, me qëllim përfshirjen e tyre në listat për formimin profesional dhe punësi kur është e mundur.
- Shërbimi i Provës përmbush detyrimet ligjore dhe ndjek zbatimin e vendimeve të gjykatës. Në rast të shkeljes së kushteve të vendimit informohet menjëherë prokurori i çështjes.
- DAR/ZA luajnë rol aktiv përmes vënies në dispozicion të fëmijëve të dhunuar të shërbimit të psikologëve në shkollë. Ky shërbim u ofrohet fëmijëve nëpërmjet telefonit ose mjeteve të tjera të komunikimit on-line nga psikologët e shkollave. KVDHF ndan informacion të vazhdueshëm me DAR/ZA në lidhje me rastet e identifikuar të fëmijëve të përballur me dhunë të drejtpërdrejtë ose të asistuar në familje.
- Eksperti mjeko-ligjor kryen ekspertimin e dëmtimeve edhe gjatë situatës së COVID-19 duke respektuar detyrimet me të cilat e ngarkon ligji, si dhe duke zbatuar një protokoll strikt të mbrojtjes nga rrezik për infektimin apo përhapjen e COVID-19. Kur konstaton se viktimë ka nevojë të caktuara si për mbështetje psikologjike apo të tjera, komunikon menjëherë me KVDHF për të mundësuar referimin në specialistët përkatës.
- Prokuroria ndan informacion se lëshimi i Urdhrave të mbrojtjes nuk pengon ndjekjen penale të rasteve të dhunës në familje dhe informon mbi ndjekjen penale të veprave të dhunës në familje për raste konkrete të trajtuara ose që po trajtohen nga ETN dhe tendenca gjatë COVID-19. Gjithashtu theksohet orientimi nga viktimat duke shpjeguar edhe rolin e koordinatores për viktimat në prokurori dhe përshtatjen e këtij roli përmes mjeteve on line të komunikimit gjatë COVID-19.

- Të gjitha institucionet që duhet të kenë dijeni për rastin ruajnë konfidencialitetin e të dhënave, kur ka dyshime ose rezulton se rasti i dhunës në familje është infektuar nga virusi i COVID-19; Informacioni ndahet vetëm kur nevojitet për të garantuar shëndetin e viktimës dhe të anëtarëve të MKR/ETN, të cilët kanë qenë në kontakt ballë për ballë me të.
- Kur për nevoja të menaxhimit të rastit nevojiten dokumente ato ndahen nëpërmjet e-mailit, për të shmangur kontaktin fizik mes institucioneve.
- Punonjësit që garantojnë sigurinë e viktimës në gjykatë zbatojnë me rigorozitet masat mbrojtëse.
- Kur rasti ndiqet penalisht, koordinatorja e viktimave në prokurori që informon viktimën respekton masat mbrojtëse dhe/ose përshtat mënyrën e informimit. Sugjerohet të asistojë viktimat nëpërmjet një materiali të përgatitur dhe printuar me informacion mbi të drejtat e tyre dhe ndjekjen e procedurave penale.
- Gjithashtu të gjithë aktorët e tjerë të MKR (mjeku ligjor, zyra e përmbarimit, drejtoria arsimore, ZVA, ZVP, etj) marrin masa të ofrojnë mbështetjen e nevojshme për rastin duke respektuar masat mbrojtëse dhe/ose përshtatur mënyrën e informimit (telefon, online, etj).

### **Të rëndësishme për t'u mbajtur në konsideratë përgjatë situatës së pandemisë COVID-19:**

- KVDHF në bashkëpunim me anëtarët e ETN-së marrin masa të vënë në dispozicion të publikut/qytetarëve informacion mbi mënyrat e raportimit të dhunës në familje, ku të theksohet funksionimi i strukturave përgjegjëse për menaxhimin e rasteve të dhunës edhe në situatën COVID-19.
- KVDHF dhe anëtarët e ETN-së marrin masa për publikimin e numrave të disponueshëm për raportimin e dhunës në faqet online të Bashkisë, Shëndetësisë, Policisë, etj, si numrin e Policisë së Shtetit 129, Numrin e Linjës Kombëtare të Këshillimit 116 117, numrat e emergjencës/numrat e gjelbër të vënë në dispozicion nga bashkia në këtë situatë, apo edhe numrin e KVDHF kur është e mundur.

**KUJDES!** Në menaxhimin e një rasti jo-emergjent edhe gjatë situatës së pandemisë së COVID-19, mund të lindë nevoja të përfshihen një numër i anëtarëve të ETN-së, siç përkthehen në seksionin 4.4.1. të "Protokollit të Menaxhimit të rasteve të dhunës në familje nëpërmjet Mekanizmit të Koordinuar të Referimit", duke i zbatuar ato përmes ndjekjes dhe aplikimit me përpikmëri të rregullave të përgjithshme të përkthura në seksionin 1 të këtij Protokoll. Prandaj referenca në seksionet dhe anekset përkatëse të Protokollit të menaxhimit të rasteve në jo në kushte emergjence, në varësi të karakteristikave dhe nevojave të rastit për trajtim jo-emergjent mbetet domosdoshmëri, POR gjithmonë duke bërë maksimumin e mundshëm për zbatimin e rregullave të përgjithshme kundër pandemisë së COVID -19

## 4. MATERIALE TË TJERA INFORMUESE

- Urdhër i Ministres së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale datë 24 Janar 2020 për "Përforcimin e përgatitjes për tu mbrojtur ndaj depertimit së koronavirusit të ri dhe parandalimit të përhapjes së tij në Shqipëri" (<https://shendetesia.gov.al/masat-e-marra-per-parandalimin-e-koronaravirusit-te-ri-ne-shqiperi/>)
- Plani i Veprimit për Shqipërinë: "Parandalimi, përgatitja dhe përgjigja kundër COVID-19", përgatitur nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Instituti i Shëndetit Publik ([https://shendetesia.gov.al/wp-content/uploads/2020/03/Covid\\_AL-spreads.pdf](https://shendetesia.gov.al/wp-content/uploads/2020/03/Covid_AL-spreads.pdf))
- Vendim i datës 08.03.2020 i Komitetit të Përkohshëm për infeksionin e përhapur nga koronavirusi i ri (<https://shendetesia.gov.al/wp-content/uploads/2020/03/Urdher-53-Ngritje-Komiteti-.Koronavirus-2.pdf>)
- Urdhër i Ministres së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale Nr. 157, datë 10.03.2020 "Për marrjen e masave për parandalimin e infektimit nga COVID-19 të përfituesve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror"
- Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 243 datë 24.03.2020 "Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore" (<https://shendetesia.gov.al/wp-content/uploads/2020/03/VKM-nr.-243-date-24.3.2020.docx.pdf>)
- Akt Normativ i Këshillit të Ministrave Nr.8 datë 24.03.2020 "Për disa shtesa dhe ndryshime në aktin normativ nr.3, datë 15.03.2020 të Këshillit të Ministrave "Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19", të ndryshuar; <https://shendetesia.gov.al/wp-content/uploads/2020/03/akt-normativ-2020-03-24-8.pdf>
- Udhëzim nr.253, datë 10.4.2020, " Për menaxhimin e rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje gjatë periudhës së fatkeqësisë natyrore për arsye të epidemisë së shkaktuar nga COVID-19", të Ministrit, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale; <https://www.unicef.org/albania/media/2761/file/Udhezim%20nr%20253.pdf>
- Akti Normativ nr.9, datë 25.03.2020, "Për marrjen e masave të veçanta në fushën e veprimtarisë gjyqësore, gjatë kohëzgjatjes së gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga COVID-19". <https://qbz.gov.al/.../50/e3fcdb87-677d-4df7-98d8-875bccc757b2>
- Urdhër i Ministres së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 254 datë 10.04.2020 "Protokolli i funksionimit të qendrave rezidenciale publike dhe jo-publike që ofrojnë shërbimin e strehimit (strehëzat) për viktimat e dhunës në familje dhe trafikimit në situatën e pandemisë së COVID-19"
- Udhëzim nr. 744 datë 15.11.2019 "Për miratimin e standardeve minimale të shërbimeve të përkujdesit shoqëror, për viktimat/të mbijetuarat e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje në qendrat rezidenciale emergjente (afatshkurtëra) publike dhe jo-publike (strehëzat emergjente)"
- Akt Normativ Nr.13, datë 2.4.2020 "Për marrjen e masave të veçanta në fushën e veprimtarisë së shërbimit përmbartimor gjyqësor, ndërmjetësimi"

dhe administrimit të procedurave të falimentit, gjatë kohëzgjatjes së gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga covid 19". <https://qbz.gov.al/eli/fz/2020/57/76b7f625-3fb2-4e59-a736-2405096d10e2?fbclid=IwAR2lpDgLwOMdd4nneiDt8VfHgVuT-xkQ1g9a67RcckboPwBTmOgWKXLd-wM>

- Vendim nr.305, datë 16.4.2020 i Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës së përfitimit të ndihmës financiare për të punësuarit aktualë dhe punonjësit e larguar nga puna si pasojë e covid-19".
- <https://qbz.gov.al/eli/vendim/2020/04/16/305/19776fdf-bc9c-4d68-9332-d1ba38f5c463>





